

LIGJ
Nr. 9705, datë 02.04.2007

**PËR FALJEN E KAMATËVONESAVE TË PAPAGUARA TË KONTRIBUTEVE
TË SIGURIMEVE TË DETYRUESHME SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital tërësisht shtetëror, institucioneve shtetërore, buxhetore e jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive me kapital të përbashkët me shtetin, personave juridikë dhe fizikë privatë dhe personave të vetëpunësuar në bujqësi u falen kamatëvonesat e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të papaguara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që detyrimet për kontributet të arkëtohen brenda datës 31.12.2007.

Kamatëvonesat e papaguara falen edhe kur kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore janë paguar para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Pushohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave, që kanë marrë formë të prerë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për pjesën e kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të cilat falen me këtë ligj.

Neni 3

Kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, të paguara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kthehen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 5266, datë 17.04.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred MOISIU
Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 48 datë 24.04.2007